



Ndërtesa e ElektroKosovës / ElektroKosova Building
Bulevardi Bill Clinton nr.3 / Bill Clinton Boulevard no.3
Prishtinë 10000 / Prishtina 10 000
Republika e Kosovës / Republic of Kosovo

KOMPANIA KOSOVARE PËR FURNIZIM ME ENERGJI ELEKTRIKE SH.A.
KOSOVO ELECTRICITY SUPPLY COMPANY J.S.C.
KOSOVSKO PREDUZEĆE ZA SNABDEVANJE ELEKTRIČNOM ENERGIJOM D.D.

KESCO SH.A.

Nr. 40 Dt. 19.07.2022

HQ 1

Për: **Zt. Ymer Fejzullahu**
Kryesuesi Bordit
Zyra e Rregullatorit për Energji

CC: **Znj. Artane Rizvanolli**
Ministre e Ekonomisë

Bordi i ZRRE-së

Zt. Petrit Pepaj
Drejtor Menaxhues – ZRRE

Datë: 19.07.2022

Ref: Kërkesë për hapjen e Shqyrtimit të Jashtëzakonshëm për të Hyrat e Lejuara Maksimale për Furnizuesin me Shërbim Universal

Viti 2021 u karakterizua me rritje enorme të çmimeve të energjisë elektrike, të cilat sollën pasoja të likuiditetit dhe rritje të kostove në sektorin energjetik të shumë vende evropiane, përfshirë edhe Kosovën. Pas kërkesave të vazhdueshme nga te licencuarit e energjisë elektrike në Kosovë, ZRRE më 13 dhjetor 2021 hapi shqyrtimin e jashtëzakonshëm për të hyrat e lejuara maksimale për operatorët e rregulluar. Procesi u përmyll në shkurt të vitit 2022 me vendimin e të hyrave të lejuara maksimale për FSHU-ne , Vendimi nr. V_1485_2022 të dt. 7 shkurt.

Sipas vendimit në fjale, ZRRE vlerësoi dhe miratoi që të hyrat e lejuara maksimale për Furnizuesin me Shërbim Universal të jenë në vlerë prej 347.28 milion €. Edhe sepse kjo vlerë nuk i mbulonte të hyrat e lejuara maksimale, ZRRE-ja në arsyetimin e vendimit shkruan se në vlerësimin e kostove ka marrë për bazë zotimin për subvencion shtesë prej 10 milion euro sipas Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 05/55 të dt. 21.01.2022, si dhe Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për subvencionimin prej 90 milion eurove shtesë sipas vendimit nr. 01/60 të dt. 05.02.2022. Me fjale të tjera, të hyrat maksimale janë zvogëluar në të gjitha përlogaritjet në vlerë prej 100 milion eurove.

Konform këtij vendimit me dt. 08.02.2022, ZRRE aprovoi edhe tarifën fundore të energjisë elektrike, të cilat shënuan rritje vetëm për konsumatorët shtëpiak me konsum mbi 800 kWh, në fuqi nga data 9 shkurt 2022.

Furnizuesi me Shërbim Universal përmes shkresës zyrtare me dt. 11.02.2022 ka ngritur shqetësimet e veta lidhur me modalitetin e ndarjes dhe pagesave të këtij subvencioni, por nuk ka marrë përgjigje zyrtare. I përballur me paqartësi, FSHU ka komunikuar dhe shkëmbyer shkresa zyrtare me ZRRE-në dhe Ministrinë e Ekonomisë dhe i njëjti i është përgjigjur të gjitha kërkesave të pranuar nga institucionet përkatëse lidhur me llogaritjen e vlerës së subvencionit për muajt përkatës. Megjithatë, deri me sot, FSHU nuk ka

pranuar asnjë rimbursim dhe njëkohësisht nuk ka marre ndonjë informate se kur mund te priten pagesat ne fjale.

Situata e krijuar gjate kësaj periudhe ka detyruar FSHU-ne te operoj nen-kosto, duke e bere shume te veshtire e deri diku te pamundur per te plotësuar obligimet edhe ndaj palëve te treta.

Vlera e subvencionit e kalkuluar per konsumatorë sipas çmimeve te dërguara nga ZRRE-ja, per periudhën 9 shkurt-30 qershor 2022 ka tejkualarën vlerën prej 31 milion eurove. Mungesa e rimbursimit te kësaj vlere te kalkuluar te subvencionit, tejkalon prapun e materialitetit prej 5% ashtu siç parashihet ne nenin 11 të Rregullës per te Hyrat e FSHU-së, duke mundësuar hapjen e shqyrtimit te jashtëzakonshëm.

Çmimet e energjisë elektrike ne tregjet ndërkombëtare vazhdojnë te jene te larta, me rreth 465.89 €/MWh¹ ne muajin korrik, ndërsa parashikimit per kartelin e 4 te vitit 2022 tejkalojnë çmimin prej 663 €/MWh². Kostoja e realizuar e blerjes per energji eklektike per muajt Janar-Maj per Furnizuesin me Shërbim Universal është 81.93 milion €, apo ne vlerën e njëjtë te koston se blerëve te lejuara per total vitin 2022.

Blerjet e energjisë elektrike (në mil €)	Lejua nga ZRRE (Janar-Dhjetor)	Aktual (Janar-Maj)
Blerjet nga KEK	118.37	56.52
Blerjet nga Importi	21.80	12.05
Blerjet nga BRE-të	40.94	13.36
Subvencioni	(100)	-
Total	81.12	81.93

Ngjashëm, analiza e kostove te realizuara per muajt Janar-Maj 2022 krahasuar me te hyrat e realizuara per periudhën e njëjtë, jep një diference prej 40.89 milion €, respektivisht tejkalon prapun e materialitetit prej 5%, si paraqitet ne tabelën ne vijim:

Përshkrimi	Kostot në mil €
Kostot për blerjen e energjisë	81.93
Kostot tjera	109.50
MAR	191.43
Të hyrat e realizuara	150.54
Pambulueshmëria Janar-Maj	40.89
Pambulueshmëria Janar-Maj në %	21.36%

Nga analizat e mësipërme është fakt se efekti i mungesës se rimbursimit te subvencionit te energjisë elektrike vetëm per muajt shkurt-maj 2022 ka ndikuar qe te tejkalohej pragu i materialitetit per Furnizuesin me Shërbim Universal. Duke marre parasysh pritshmerit per rritje te mëtutjeshme te çmimeve te energjisë elektrike, remonteve te njësive gjeneruese respektivisht rritjen e varshmerise ndaj importit,

¹ Hupx, Cmimi per dt. 19 korrik 2022 <https://hupx.hu/en/> (Marre me dt. 18.07.2022)

² Hudx, Cmimet per Q5 <https://hudex.hu/en/market-data/power/daily-data#quarter> (Marre me dt. 18.07.2022)

furnizuesi i vetëm nuk mund të përballoj me tej këto kosto, veçanërisht se i njëjti tashme është afektuar dukshëm nga efekti i fund-vitit 2021. Si i tille, Furnizuesi kërkon nga ZRRE-ja të shqyrtoj kërkesën për hapjen e shqyrtimit të jashtëzakonshëm për të hyrat e lejuara maksimale.

ZRRE ka autoritet të caktuar me ligj për të vendosur tarifa që do të aplikohen nga të licencuar dhe të cilat do t'i ngarkohen konsumatorëve fundor. Në këto rrethana, ZRRE-ja ka duhet të krijojë dhe mbajë një ekuilibër optimal ndërmjet konsumatorit dhe të licencuarve. Furnizuesi me Shërbim Universal kërkon nga ZRRE të shqyrtoj me seriozitet dhe prioritet kërkesën e FSHU-se, në të kundërtën krijohen probleme me të thella financiare, të cilat mund edhe të rrezikojnë sigurinë e furnizimit me energji elektrike.

Me respekt,



Mesut Serhat Dinc
Drejtor Menaxhues
KESCO sh.a.